



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

Nr. _____ Prot.

Date ____/____/2021

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

14/05/2021

Për: Operatorin Ekonomik “LINDA-80” Shpk, me adrese Rruga Kryesore Lezhe – Tirane km 3, ISHULL-SHENGJIN, Lezhe.

* * *

Procedura e prokurimit: **E Hapur/ Mallra**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-92292-04-06-2021**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje Naftë për nevojave të Bashkisë Lezhe”

Kohëzgjatja: **12 Muaj nga data e nënshkrimit të Marreveshjes Kuader.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “GEGA CENTER GKG” Shpk, me NUIS K66801001T, me ofertë ekonomike me marzh fitimi 5.8 % (pese pike tete).
2. Operatori Ekonomik “LINDA-80” Shpk, me NUIS K37513530U, me ofertë ekonomike me marzh fitimi 22.90 % (njëzet e dy pike nentedhjetë).

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Operatori Ekonomik “GEGA CENTER GKG” Shpk, me NUIS K66801001T

Përkatësisht për arsye të mëposhtme:

I- Operatori Ekonomik “GEGA CENTER GKG” Shpk, me NUIS K66801001T

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se:

Në “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, te DST-se, ne piken 2.3.7, Operatori ekonomik duhet të disponoje të pakten një pikë të furnizimit me karburant në pronësi apo me qera, në një distancë jo më shumë se 5 (pesë) km nga qyteti i Lezhës.

a- Për të provuar kriterin e mesipër OE duhet të paraqesë kontratë qiraje apo Çertifikatë/Vertetim Pronësie,

b- Për të vertetuar kriterin e distancës, KVO-ja, do të referohet ekstraktit të QKB të subjektit (vendndodhjes së ushtrimit të aktivitetit), nëpërmjet adresës elektronike të QKB-së.

c- Stacioni i tregimit të karburantit detyrimisht duhet të jetë i pajisur me:

- Leje mjedisore leshuar nga QKL, sipas legjislacionit në fuqi.
- Vertetim teknik leshuar nga ISHTI ose Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK),
- Certifikatë e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmerisë datën e hapjes së ofertave.

Sa më sipër nga verifikimi rezulton se OE ka paraqitur kontratën e qiraje Nr. 2478 Rep, 1188 Kol, të datës 09.07.2020. Në nenin 1, pikë 1,1 “Objekti i kontratës së qiraje”, të kësaj kontrate të dhenat e adresës së pasurisë janë nr. pasurie 211/19, Zona kadastrale 1087, adresa Balldre i vjeter, ndërkohe që në certifikatën e pasurisë bashkëngjitur kontratës së lartpërmendur, të dhenat e pasurisë janë pasuria nr. 211/129 dhe zona kadastrale 1086, (ndryshon zona kadastrale).

Pavarësisht kësaj, për më tepër referuar ekstraktit të QKB -së, adresat e deklaruara nga ana juaj si vende ku ushtroni aktivitetin tuaj, adresa e pasqyruar në kontratën e qiraje, nuk përputhet me asnjë nga adresat e deklaruara në vendndodhjet e ushtrimit të aktivitetit në Lezhë.

Sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur në nenin 77, pikë 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pikë 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e

nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e OE “GEGA CENTER GKG” Shpk, per mos permbushje te kritereve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “GEGA CENTER GKG” Shpk, *skualifikohet*.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “LINDA-80” Shpk, me adrese Rruga Kryesore Lezhe – Tirane km 3, ISHULL-SHENGJIN, Lezhe, se oferta e paraqitur, me marzh fitimi ne perqindje prej 22.90 % (njëzet e dy *pike* nentedhjetë) është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkise Lezhe sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit dhe dokumentacionin e ofertes tuaj te noterizuar, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 83, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05/05/2021

Ankesa: Nuk ka.

TITULLARI AUTORITETIT KONTRAKTOR
K R Y E T A R I
Pjerin NDREU